

24.08.2017
[Signature]

[Faint stamp text]
255/4
24.08.2017



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	24.08.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 255/4
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren <i>[Signature]</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë <i>[Signature]</i>

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.75/2017 të dt. 07.08.2017 për lëndën Jeton Hisari Nr. nr.04-353-69160 për renovimin dhe restaurimin e objektit shtëpi individuale për banim me lokal afarist, në ngastrën kadastrale Nr.3092-2-651-0 dhe 3092-2 Z.K. Prizren.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.



INSTITUT ZA ZAŠTITU SPOMENIKA
440 21.08.2017

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 75/2017
Datë: 07.08.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

VENDIM

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi, me kushte, i projektit ideor për renovimin/ restaurimin objektit shtëpi individuale për banim dhe lokal afarist në parcelën nr. 3092-2-651-0 dhe 3092-2– 0 Z. K. Prizren.
2. Në bazë të rekomandimit dhe arsytimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues i cili duhet të shqyrtohet dhe aprovohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e zyrtarëve profesional nga Qendrat Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Jeton Hisari nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për renovimin dhe restaurimin e objektit - shtëpisë individuale për banim dhe lokal afarist, në ngastrën kadastrale me Nr. 3092 - 2 - 651 - 0 dhe 3092 - 2. Sipas planit të Konservimit dhe Zhvillimit për Zonën Historike të Prizrenit, ndërtesa që do të rinovohet gjendet në zonën e III - të, Zona e kejit të lumit. Objekti që parashihet të rinovohet gjendet e listuar në shtojcën e II - të të Ligjit Nr. 04/L - 066 për Qendrën Historike të Prizreni, si Objektet e Banimit me nr. Rendor 43 (shtëpia e Hilmi Hisarit). Kërkesa e mëparshme e palës për rrënim dhe rindërtim në këtë parcelë është refuzuar nga Komisioni në takimin e datës 24.02.2017 dhe Komisioni ka rekomanduar vetëm ndërhyrje konservuese/restauruese të ndërtesës ekzistuese. Nga komisioni kërkohet vlerësimi i intervenimeve për renovimin e ndërtesës ekzistuese. Në projekt vërehet që për t'u përforcuar struktura ekzistuese e ndërtesës, e cila ka gjendje mjaft të rëndë fizike, është përdorur sistem skeletor me beton arme. Janë paraparë shtyllat nga BA të cilat depërtojnë edhe brenda strukturës ekzistuese, si dhe i gjithë konstruksioni meskatësh do të zëvendësohet me pllakë nga BA. Komisioni diskuton se kjo ndërhyrje nuk është e rekomanduar në ndërtesa me status të mbrojtur, ku ndërhyrja në strukturë është shumë e madhe, si dhe materiali i propozuar, beton arme, është jokompatibil, me materialet e ndërtesës së mbrojtur, qerpiq e dru. Rekomandohet pala që të bëjë përforcimin e ndërtesës, si dhe konstruksionet meskatëshe nga druri, duke përdorur edhe përfocime çeliku aty ku është e nevojshme.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Të aprovohet projekti ideor për renovimin dhe restaurimin e objektit shtëpi individuale për banim dhe lokal afarist në parcelën nr. 3092-2-651-0 dhe 3092-2, me pronar Jeton Hisari me kusht që:
 - 1.1. Në vend të përforcimit të strukturës së ndërtesës ekzistuese me materiale nga Betonarmeja, struktura të përforcohet me konstruksion druri dhe pjesërisht çeliku.
 - 1.2. Po ashtu edhe konstruksionet meskatëshe të punohen nga materiali i drurit dhe jo nga pllaka betonarme.
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese - Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK-Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK - Prizren (një për QRTK - në dhe një për IKMM - në).

Mbi bazën e këtij arsyetimi (rekomandimi të Komisionit) është vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi. Kushtet e vendosura në arsyetim konsiderohen në tërësi, obligative.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM – së;
- Arkivit të IKMM – së;
- Arkivit të MKRS – së;

